

# MANUAL I PËRDORIMIT: PROPAY KULETA DIGJITALE



Tani telefoni është kuleta juaj digjitale. Paguaj sigurt dhe shpejt.



Anderson APP on Google: play



## ProPay Kuleta Digjitale në aplikacionin mobil të ProCredit Bank

Kuleta digjitale, është shërbim i cili ju mundëson të bëni pagesa në pajisjet POS, me telefonin tuaj të mençur. Ky shërbim ju mundëson që kartelën tuaj të lidhni me telefonin tuaj dhe pa pasur nevojë ta keni kartelën me vete të bëni pagesa me telefon.

Përdorimi i Kuletës Digjitale ProPay ju mundësohet të gjithë klientëve të ProCredit Bank që e kanë në shfrytëzim aplikacionin mobil të bankës në telefonin e tyre të mençur **Android** dhe si metodë të sigurisë e kanë të zgjedhur metodën e kodit të sigurisë përmes SMS. Po ashtu, telefoni duhet të jetë i pajisur me teknologjinë NFC në mënyrë që kuleta të mund të funksionon.

Për të shfrytëzuar kuletën digjitale, nevojitet që aplikacionin mobil të bankës të bëni update në versionin e fundit që gjendet ne Google Playstore.

\*Për të gjitha informatat që mund të ju nevojiten për Aplikacionin Mobil të ProCredit Bank, ju lutemi qasuni në **Manualin për aplikacionin mobil** që mund të gjeni në faqën kryesore të Ebanking.

Në momentin që kyçeni në aplikacion, do të ju shfaqet porosia **Funksione të reja - ProPay Kuleta Digjitale.** Këtu keni mundësinë të shtoni kartelën e juaj në kuletë në mënyrë që të përdorni atë për pagesa me telefon.



Shënim: Nëse nuk shtoni ndonjë kartelë në kuletën digjitale, kjo porosi do të ju shfaqet çdo herë që kyçeni në aplikacionin mobil. Nëse nuk dëshironi të ju shfaqet kjo porosi, mund të klikoni në kutinë **Mos e shfaq këtë mesazh** dhe ajo nuk do të paraqitet më.



### Lidhja e kartelës me kuletën digjitale

Nëse dëshironi të shtoni kartelën e juaj në kuletën digjitale, klikoni në butonin SHTONI KARTELËN.

Në vijim do të ju kërkohet të caktoni një PIN 4 shifror i cili mund të ju kërkohet më vonë në raste të modifikimeve dhe konfigurimit të kuletës. Po ashtu, ky PIN ju kërkohet edhe për autorizim të pagesave që tejkalojnë shumën maksimale të lejuar për pagesa pa kontakt dhe pa PIN.

	← Kor	nfigurimi i Kuletës	Digjitale	← Konfig	urimi i Kuletës I	Digjitale
		Vendos PIN kodir	n e ri	Ve	ndos PIN kodin	e ri
~			_			
Kuleta Digjitale duke startuar	SHFAQNI PIN KODIN			SHFAQNI PIN KODIN		
	1	2	3	1	2	3
	4	5	6	4	5	6
	7	8	9	7	8	9
	×	0		×	0	۲
		ANULO			ANULO	
	Ш	0	<	111	0	<

Aplikacioni do të ju njofton se është duke konfiguruar kuletën tuaj.





Në vijim nevojitet të zgjedhni kartelën të cilin dëshironi të lidhni me kuletën digjitale.



Pasi të keni zgjedhur kartelën, shtypni butonin Vazhdo. Në faqen në vijim shtypni butonin Konfirmo dhe do të hapen kushtet dhe rregullat e përdorimit të shërbimit Kuleta Digjitale.

Në vijim, shtypni butonin Vazhdo dhe do të hapet faqja ku për të përfunduar procesin e shtimit të kartelës nevojitet të shënoni kodin e sigurisë që do të pranoni përmes SMS.

Pasi të keni vendosur kodin e sigurisë, do të shfaqet mesazhi se kartela juaj është shtuar me sukses në kuletën digjitale.

\*Për një kohë të shkurtër kartela mund të ketë statusin "Në pritje" deri sa të përfundon konfigurimi.



← Shtoni kartelën	← Shtoni kartelën	← Shtoni kartelën
Ju lutem kontrolloni dhe konfirmoni	<ul> <li>Kushtet dhe Rregullat</li> <li>kalendarike më herët.</li> <li>4.2 Banka nuk mban përgjegjësi për dëmet që vijnë nga arsyet që janë jashtë kontrollit të saj, të cilat Banka nuk ishte në gjendje ti parandalonte ose shmangte, siç është për shembull dështimi i infrastrukturës telekomunikuese.</li> <li>4.3 Banka nuk do të jetë përgjegjëse për fuksionimi ne pajisjes suaj mobile apo aplikacionit pasi qe jane sherbime qe ofrohen nga palet e treta.</li> <li>4.4 Kjo Marreveshje rregullohet edhe me kushtet e definuara ne Marreveshjen pe lëshim te kartelës suaj bankare, Marreveshjen per E-banking (Perfshire aplikacionin mobil M-Banking), Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme të ProCredit Bank-Bizneset dhe Konsuamtorët (persona fizik) varësisht a eshte klienti biznes apo person fizik dhe çmimores se bankës.</li> </ul>	Ju lutem kontrolloni dhe konfirmoni
KONFIRMO		KONEIRMO
ANULO	ANULO	ANULO
Shtoni kartelën	← Kuleta Digjitale ProPay	: 🔶 Kuleta Digjitale ProPay 🛛 :
<b>V</b> Kërkesa e juaj është pranuar.	ProCredit Bank       (*))         DIRECT       debit         XXXX XXXX XXXX 1111       (*)         EXP. 11/20       (*)         Kartela në pritje       (*)	r r r r r r r r r r r r r r
	Kuleta Digjitale është aktivizuar dhe gatshme për pagesa	e Kuleta Digjitale është aktivizuar dhe e gatshme për pagesa Kartelat ne Kuletën Digjitale janë përditësuar. Ju lutem rishikoni ndryshimet.
MBYLL	SHTONI KARTELËN	SHTONI KARTELËN

Tashmë kuletën digjitale e keni të gatshme për shfrytëzim me kartelën që keni lidhur. Kjo kartelë automatikisht përzgjedhet si kartela primare për pagesa.



Nëse dëshironi të shtoni edhe kartela tjera në kuletën digjitale, këtë mund të bëni duke shtypur butonin SHTONI KARTELA. Procesi i njëjtë vijon edhe në këtë rast.

Kur keni më shumë se një kartelë të lidhur për kuletën digjitale, keni mundësinë të zgjedhni cila kartelë do të jetë primare për pagesa. Mundësinë e ndryshimit të kartelës primare e keni në çdo kohë.

ProCredit Bank II)) DIRECT debit	ProCredit Bank	)))) dehit
XXXX XXXX XXXX 0000 EXP 11/20	XXXX XXXX XXXX 1111 EXP. 11/20	
Kartela primare	Cakto kartelën Primare	
	Të gjitha transaksionet e inici (Aprovuara ose Refuzuara) Dje	Jara
	22:34	-€100.00
$\langle \rangle$	22:34	-€15.00
Kuleta Digjitale është aktivizuar dhe e	22:33	-€15.00
gatshme për pagesa	22:33	-€15.00
	22:33	-€15.00
SHTONI KARTELËN	PAGUAJ ME KËTË KAR	TELË

### Përgatitja e Kuletës për pagesa dhe realizimi i tyre

Për të kryer pagesa me kuletën digjitale, nevojitet që NFC të keni të aktivizuar në telefonin tuaj. Nëse nuk e keni NFC të aktivizuar, kuleta digjitale do të ju informon për këtë dhe do të ju jep opsionin për të aktivizuar atë.

Nëse në telefonin tuaj keni edhe kuleta tjera digjitale, atëherë përmes Settings të telefonit nevojitet të përzgjedhni kuletën primare që dëshironi të shfrytëzoni.





\*Në rast se telefoni juaj nuk përkrah NFC, sapo të keni shtypur opsionin e kuletës digjitale do të pranoni mesazhin si më poshtë:



Te menyja Parametrat e Sigurisë, keni mundësine të zgjedhni metodat e autentikimit të pagesës.





Kjo është menyja ku po ashtu mund të menaxhoni kuletën tuaj digjitale.

Këtu mund te shlyeni kuletën, të ndryshoni PIN, të menaxhoni qasjen NFC apo të shkyçeni nga kuleta digjitale (Deri sa të kyçeni prapë në kuletën digjitale, pagesat me telefon nuk do të jenë active).

Janë 4 mënyra që mund të autentikoni një pagesë:

Me ekran të hapur të telefonit ose vetëm me telefon të hapur (unlocked) mund të bëni pagesa deri në 40 EUR.

Me vendosjen e PIN kodit të kuletës ose me autentikim Biometrik (me shenja te gishtërinjve) mund të bëni pagesa deri në 500 EUR.

← Parametrat e Sigurisë	
Metodat e Autorizimit	
Të dhënat biometrike	1
Shuma maksimale e aprovuar	€500.00
Aktivizuar për pagesa	
PIN kodi	÷
Shuma maksimale e aprovuar	€500.00
Numri maksimal i tentimeve	5
Numri i tentimeve aktuale	0
Aktivizuar për pagesa	
Ekrani i hapur	2
Shuma maksimale e aprovuar	€40.00
Aktivizuar për pagesa	
Automatik	ð
Shuma maksimale e aprovuar	€40.00
Aktivizuar për pagesa	
	_



Për të kryer një pagesë në pajisjen POS, vlera e blerjes shënohet dhe pastaj afrohet telefoni te lexuesi pa kontakt në POS.

Kuleta digjitale do të hapet në mënyrë automatike dhe do të lexoj vlerën e transaksionit nga POS.

Deri ne shumën 40 EUR, transaksioni autorizohet automatikisht vetëm me prekjen e telefonit.

Në telefon do të ju shfaqet porosia se pagesa është kryer me sukses.



Për pagesat mbi vlerën 40 EUR, do të ju kërkohet vendosja e PIN-it të kuletës digjitale (që keni caktuar në fillim të procesit gjatë konfigurimit të kuletës) ose autentikimi biometrik (me shenja të gishtërinjve, nëse telefoni ju përkrah këtë opsion).

Pasi të shënohet vlera e pagesës në POS, afroni telefonin. Në POS do të shfaqet mesazhi SHIKO INSTRUKSIONET NË TELEFON. Shikoni telefonin dhe vendosni PIN-in e kuletës digjitale apo autentikohuni me opsionin biometrik. Pas kësaj keni 1 minutë kohë që të afroni telefonin përsëri te pajisja POS në mënyrë që të përfundoni pagesën.





Një metodë tjetër e pagesës është ku ju mund së pari të hapni aplikacionin mobil dhe të shtypni butonin PAGUAJ ME KULETEN DIGJITALE PROPAY pa pasur nevojë të kyçeni në aplikacion.

Këtu mund të zgjedhni kartelën e preferuar dhe metodën e autentikimit për pagesën në fjalë.

ProCradit Bank	ProCredit Pay	ProCredit Pay Paguaj me				
Kosovo TEST	Paguaj me					
EMRI I PËRDORUESIT	ProCredit Bank »)	)	k )))	🧑 P	roCredit B	anı
FJALËKALIMI	DIRECT det	oit	debit		DIRECT	
Vendosni fjalëkalimin	XXXX XXXX XXXX 0000				XX XXXX 000	00
Ruaj emrin e përdoruesit 🗹	EXP11/20			<sub>EXP</sub> , 11/	20	
HYRJE	• • Autorizoni duke përdorur		Autoriz	•• oni duke p	ërdorur	
KENI HARRUAR FJALËKALIMIN? PAGUAJ ME KULETËN DIGJITALE PROPAY		>	PIN kodi		max. €500.00	>
NDRYSHONI GJUHËN	PIN kodi max. €500.00	>	Të dhënat	biometrike	e max. €500.00	>
	Z Ekrani i hapur max. €40.	00 >	🚽 Ekrani i ha	apur	max. €40.00	>
	Automatik max. €40.	00 <b>&gt;</b>	Automatik	(	max. €40.00	>
KONTAKTONI BANKËN	ANULO			ANULO		

Për vlerat e pagesës ndër 40 EUR, prapë vetëm do të ju nevojitet të afroni telefonin te POS.

Për vlerat mbi 40 EUR, metoda e autentikimit që keni zgjedhur, do të aktivizohet.



11:40 🖾 🌡 🥌 • 😥 🍕 🖏 attal 71% 🛍	Autorizimi i pagesës			
	Vendosni PIN kodin			
	€50.00			
				Authentication Required : €500.00
	SHFAQNI PIN KODIN			<u></u>
Authentication Required	1	2	3	Authentication Required
Scan your fingerprint.	4	5	6	Scan your fingerprint.
CANCEL	7	8	9	CANCEL
	×	0		
kalanda ky Kinox	ANULO			Window Kinox



#### Resetimi i PIN-it të kuletës digjitale

Nëse keni harruar PIN-in e kuletës, mund të resetoni atë duke u qasur në meny të opsioneve të kuletës dhe dukë përzgjedhur opsionin Ndryshim PIN kodi.

Në faqen që ju hapet, nevojitet të zgjedhni opsionin Reseto PIN-in.

Do të lajmëroheni se PIN-i juaj është resetuar me sukses dhe nevojitet të caktoni nje PIN të ri.

Pasi të keni shënuar PIN-in e ri, ju kërkohet të vendosni kodin e sigurisë që ju dërgohet përmes SMS dhe procesi përfundon.



#### Ju lutem konfirmoni





### Zhbllokimi i kuletës digjitale

Në rast bllokimi të kuletës digjitale, kjo për arsye të tentimeve të paautorizuara të ndryshimeve të parametrave të sigurisë, kuleta digjitale mund të zhbllokohet nga ju me procedurën e resetimit të PIN.



### Çka duhet të bëni nëse ju është vjedhur/ humbur telefoni

Në rast të vjedhjes apo humbjes së telefonit ju duhet menjëhere të informoni Bankën duke kontaktuar Qendrën e Kontaktit në numrin 038 555 555 ose 049 555 555 në mënyrë që të bëhet bllokimi i kartelave të digjitalizuara apo edhe kartelave fizike. Në rast humbjeje apo vjedhjeje të telefonit ju mund të kërkoni nga banka bllokimin e vetëm kartelave të digjitalizuara(tokenave). Përderisa mund të vazhdoni me përdorimin e kartelës fizike.